



18 -10- 2017

Prishtinë / Pristina

Nr. 2016-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 18.10.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **RESHAT KABASHI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Suharekë, nga subjekti politik "AAK-LDD" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Arian Zenelaj.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Suharekë, që ky vendim t'i komunikohet **Reshat Kabashit**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Suharekë, të datës 18.10.2017, Nr.1996/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Arian Zenelaj pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është Reshat Kabashi, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 18.10.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka